REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 115/26 Dt. 11.03.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për lejimin e fillimit të procedurave për ofrimin e shërbimeve konsulente nëpërmjet marrëveshjeve për shërbime të veçanta, për nevojat e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për një periudhë 1 (një) vjeçare, me qëllim të angazhimit në përditësimin e të dhënave dhe adresave dhe futjen e tyre në sistemin ARIS-kompletimin e sistemit të adresave, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse, për angazhim (pranim) e 3 (tre) konsulentëve.

2. Ky Vendim realizohet financiarisht nga buxheti i Komunës së Prizrenit-kodi buxhetor mallra dhe shërbime.

3. Obligohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

Për:

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.